



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** dhe nenit 17, shkronja **b**, të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), nenit 5, paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.3, nenit 17, paragrafët 1, 7, 8 dhe 9 dhe nenit 26 të Ligjit për planifikim hapësinor, nr. 04/L-174, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 04/L-174, korrik 2013), Udhëzimit administrativ nr. 41, 02/05, për zbatimin e Ligjit për planifikim hapësinor mbi elemente themelore të planit rregullues, nenit 15, paragrafi 15.1, shkronja **b**, nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja **b**, dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 09.10.2017, merr këtë

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR TËRËSINË URBANE "B" TË LAGJES "PRISHTINA E RE - ZONA LINDJE" 2017-2025

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Miratohet Propozimvendimi i Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje" 2017-2025.

Neni 2

Konsultimet publike

Miratimi i Planit të cekur në pikën I të këtij vendimi, bëhet pas periudhës së shqyrtimit publik, raportit, analizës dhe inkorporimit të propozimeve të dala nga shqyrtimi publik.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Në bazë të Planit rregullues të hollësishëm nga pika I e këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimi i tyre me

nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit në komunën e Prishtinës.

Neni 4 Përmbajtja

Plani rregullues i hollësishëm nga pika I e këtij vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 5 Kufiri i territorit

Territori i Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje" 2017-2025, ka sipërfaqe prej $S=109.72$ Ha. Ky plan në pjesën veriore kufizohet me tërësinë urbane "A" të PRRU "Prishtina e Re - Zona Lindje", në pjesën verilindore me fshatin Zllatar, në pjesën juglindore me liqenin e Badovcit, në pjesën perëndimore me PRRU "Prishtinës së Re - Zona Qendër", në pjesën jugore kufizohet me unazën e jashtme të qytetit dhe ndërlidhet me fshatin Hajvali.

Neni 6 Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke u bazuar në neni 11, pika 1.6.1 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifim hapësinor përmes koordinimit të drejtorive sektoriale dhe burimeve të veta njerëzore, ka emëruar ekipin profesional, i cili edhe ka hartuar Planin rregullues të hollësishëm.

Neni 7 Afati i vlefshmërisë

Plani rregullues i hollësishëm mbulon një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Neni 8 Gjuha zyrtare

Plani rregullues i hollësishëm sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të jetë në gjuhët zyrtare të komunës dhe së paku në 3 kopje të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 9
Organet për zbatim

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Organet e tjera përkatëse kompetente, do t'i kryejnë veprimet procedurale për zbatim të këtij Plani nga përgjegjësitë e tyre të parapara sipas Vendimit për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës komunale.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-350/05-0253516/17, më 10.10.2017



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur.i dipl.